



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 korrik 2013
Nr. ref:RK443/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI30/13

Parashtrues

Fatmir Metahysa

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në
Pejë, Ac. nr. 527/12, të 14 nëntorit 2012, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës
Komunale në Gjakovë, C. nr. 276/11, të 14 qershorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Fatmir Metahysa, me banim në Gjakovë.

Vendimet e kontestuara

2. Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. nr. 276/11, i 14 qershorit 2012, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 527/12, i 14 nëntorit 2012.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 20 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është e drejta e parashtruesit të kërkesës dhe obligimi i punëdhënësit të tij, PTK sh. a., në Prishtinë, dega në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi), që parashtruesit t'ia kompensojë ndryshimin në pagë mujore për pozitat montator I dhe teknik specialist, përkatësisht ndryshimin në pagë mujore ndërmjet gradës së pestë dhe gradës së shtatë të kategorizimit të pagave.

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 mars 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 22 mars 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI30/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI30/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani (anëtarë).
7. Më 3 prill 2013, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe Gjykatës së Qarkut në Pejë.
8. Më 14 qershor 2013, Kolegji shqyrtues konsideroi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve, ashtu siç janë evidencuar nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës

9. Më 4 korrik 2003, parashtruesi i kërkesës, gjatë kryerjes së detyrave të punës si montator I, kishte pësuar lëndime të rënda trupore dhe, si rrjedhojë, ishte caktuar nga punëdhënësi i tij në një pozitë të re, si teknik specialist. Ndryshimi në pagë mujore për këto dy pozita ishte 190.88 €.
10. Më 9 korrik 2009, komisioni për ankesa i punëdhënësit, me Vendimin Nr. 01-3659/09, miratoi kërkesën e parashtruesit për risistemimin e tij nga pozita montator I, në pozitën teknik specialist, dhe kompensimin në mënyrë

retroaktive për kohën që parashtruesi ligjërisht ka qenë i angazhuar si montator I, por që faktikisht ka kryer punët si teknik specialist.

11. Më 1 dhjetor 2010, punëdhënësi dhe parashtruesi lidhën kontratë pune për kohë të pacaktuar. Kontrata në fjalë, ndër të tjera, përcaktonte se parashtruesi do t'i kryejë detyrat e punës si montator I, në njësinë Telekomit i Kosovës, dhe se parashtruesit i caktohet paga bazë në lartësi të gradës 5.
12. Më 6 dhjetor 2010, kryeshefi ekzekutiv i punëdhënësit, me Vendimin Nr. 01-5975, risistemoi parashtruesin në pozitë të re të punës, me ç'rast përcaktoi se parashtruesi kryen detyrat e punës si teknik specialist dhe se i caktohet paga bazë në lartësi të gradës 5.
13. Më 14 qershor 2012, Gjykata Komunale në Gjakovë, me Aktgjykimin C. nr. 276/11, përcaktoi:

"I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Fatmir Metahysa (parashtruesi), nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, SH. A., Prishtinë – dega Gjakovë, që paditësit, i përcaktuar në punët dhe detyrat e punës teknik specialist në Gjakovë, në emër të të ardhurave personale mujore, ta shpërblejë sipas lartësisë së gradës së 7-të, në lartësi prej 908,01 €, si dhe t'ia kompensojë ndryshimin e të ardhurave personale të realizuara në emër të të ardhurave për punët e kryera në punët dhe detyrat e punës montator I (grada e 5-të), për çdo muaj nga 190,88 €, duke filluar nga data 15.07.2008 e deri më 01.01.2012, që arrin shumën e përgjithshme bruto prej 9.509, 74 €, si dhe t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumën prej 519,48 €, e kreyt këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, si e PABAZUAR".

14. Në Aktgjykimin C. nr. 276/11, të 14 qershorit 2012, Gjykata Komunale në Gjakovë, ndër të tjera, arsyetoi se vendimi Nr. 01-5975 i 6 dhjetorit 2010, i dhënë nga kryeshefi ekzekutiv i punëdhënësit "*nuk ishte goditur në mënyrën e paraparë ligjore, andaj, rezulton se me të njëjtin është pajtuar*", gjegjësisht Gjykata Komunale në Gjakovë kishte konstatuar se parashtruesi nuk ka kërkuar mbrojtje gjyqësore brenda afateve ligjore të përcaktuara me nenin 78 dhe me nenin 79 të Ligjit të punës, Nr. 03/L-212.
15. Më 14 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin Ac. nr. 527/12, vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. nr. 276/11, e 14 qershorit 2012, ndërsa ankesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi pretendon se janë shkelur të drejtat e tij themelore që burojnë nga marrëdhënia e punës, ngase atij nuk i është kompensuar ndryshimi në pagë për pozitën montator I dhe teknik specialist.
17. Parashtruesi pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë të kundërligjshme, sepse lënda e tij është shqyrtuar në mënyrë të gabuar dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë.

18. Parashtruesi pretendon se, bazuar në nenin 87 të Ligjit të punës, ai kishte paraqitur kërkesëpadi në gjykatat e rregullta brenda afateve ligjore, ndërsa të njëjtat gabimisht janë bazuar në nenet 78 dhe 79 të Ligjit të punës, kur kanë konstatuar se kërkesëpadi e tij ishte parashkruar, pra ishte paraqitur jashtë afateve ligjore.
19. Për më tepër, parashtruesi i propozon Gjykatës që të mbrojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenet: 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit; si dhe në nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive] të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Vlerësimi i pranueshmërisë

20. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore.
21. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe të lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
22. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës:

36 (1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...(c) kërkesa është qartazi e bazuar.
23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë shqyrtuar pretendimet e parashtruesit dhe kanë hedhur poshtë ankesën e tij për kompensim monetar si të paafatshme bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit të punës.
24. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi ankohet se gjykatat e rregullta gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kanë kryer gabime procedurale kur kanë konstatuar se ankesat e tij janë të paafatshme.
25. Gjykata thekson se çështjet e interpretimit të ligjit dhe të fakteve janë çështje të juridiksionit, të autonomisë dhe të prerogativës së gjykatave të rregullta; gjersa në rastin konkret kërkesa e parashtruesit ngre çështje të fakteve dhe të ligjshmërisë që në të vërtetë janë çështje të juridiksionit burimor të gjykatave të rregullta dhe nuk ngre çështje të kushtetutshmërisë.
26. Gjykata thekson se shterja e mjeteve juridike nuk nënkupton vetëm ndjekjen hap pas hapi të procedurave juridiko-formale, por dhe ngritjen e çështjeve kushtetuese para vetë gjykatave të rregullta, në mënyrë që parashtruesit të kenë një proces të rregullt kushtetues dhe që njëkohësisht t'ua japin mundësinë

gjykatave të rregullta që të vendosin sipas normave kushtetuese. (Shih nenin 102.5 të Kushtetutës).

27. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrohet autoriteteve kompetente, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, Aktvendim për papranueshmëri: AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, i 21 janarit 2010; dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25 803/94, vendim i 28 korrikut 1999).
28. Më 29 janar 2013, Gjykata në mënyrë të ngjashme shtjelloi çështjen e shterimit të mjeteve juridike dhe karakterit subsidiar të Kushtetutës në vendimin për kërkesën për masë të përkohshme dhe Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Nr. KI139/12 – parashtrues Besnik Asllani, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pkl. nr. 111/2012 i 30 nëntorit 2012.
29. Në rastin Nr. KI139/12, përkitazi me parimin e shterimit të mjeteve juridike dhe të karakterit subsidiar të Kushtetutës, Gjykata arsyetoi:

“Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Përndryshe parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Ai dështim do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t’u ankuar. (Shih, Aktvendimi në rastin KI07/09, Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).

Kurdo që kontestohet një vendim në bazë të një qëndrimi juridik që është i papranueshëm nga pikëvështrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gjykatave të rregullta që sollën vendimin, u duhet ofruar mundësia e rishqyrtimit të vendimit të kontestuar. Kjo do të thotë se, çdo herë, kur pretendohet shkelja e të drejtave të njeriut, nuk është e thënë që ky pretendim të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet paraprakisht nga gjykatat e rregullta.

...

Në praktikë, asgjë nuk e ndaloj parashtruesin e kërkesës që të ankohet para Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme për shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë. Nëse ato gjykata do ta merrnin në shqyrtim shkeljen dhe do ta korrigjonin atë, kjo do të përfundonte; nëse ato nuk do ta rregullonin shkeljen, apo nuk do ta shqyrtonin atë, parashtruesi i kërkesës do t'i kishte plotësuar kushtet e pranueshmërisë për shterimin e mjeteve, në kuptimin që këtyre gjykatave u është ofruar mundësia e korrigjimit të shkeljes së pretenduar”.

30. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese edhe me këtë rast thekson se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, *mutatis mutandis*, i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
31. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta. Si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa nr. 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 3, e 10 korrikut 1991).
32. Fakti se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë për të ngritur një kërkesë të argumentueshme për shkelje të dispozitave kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa nr. 5503/02, MezturTiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
33. Në këto rrethana, parashtruesi nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij dhe as shkeljen e nenit 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive] të KEDNJ-së, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk tregojnë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
34. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë si haptazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 8 korrik 2013, njëzëri


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani